



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANILA Q. KAÇUPI
ADRESA NR.10, RESHIT COLLAKU,
AURORA, NR.1, NR.8
TEL: 676049924

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 2420

Nr. koleksioni: 340

Tirane më 09/02/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 8 fletë



A2022052940037972178



A202205394043972178



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 09.02.2022, para meje Notere ANILA Q. KACUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RESHIT COLLAKU, AURORA, NR.1, NR.8, u paraqit personalisht:

SHITES:

Spiro Naçi, atësia Vasil, amësia Martha, shtetas Shqiptar, lindur në Janina, Greqi (GRC) dhe banues në Dropull, me adresë Kakavie; Nd. 031; H. 0; Ap. 0; Dropull I Sipërm; Kakavie; 6006; Dropull, lindur më 31/03/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033128830 dhe nr. personal J70331020K. ne cilesine e ortakut te shoqerise Aladini Trade Partner, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M02311002E, me adresë Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Sami Frasheri, Zone Kadastrale Nr.8270, Sip.311 M2, Nr Pasurie 2/510+2, Vol 41, Faqe 206/207.

BLERES:

Shoqëria VIGAN GROUP, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L61426009D, me adresë Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Medar Shtylla, Kompleksi Kika 1, Ndertesa Nr.43 Me Nr.Pasurie 8/386n25, 8386nr. 26, përfaqësuar nga Administratori Arsid Rraboshta, atësia Agim, amësia Saimire, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Rezidenca Kodra E Diellit; Nd. 005; H. 3; Ap. 06; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 19/04/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037119450 dhe nr. personal I30419101R.

Shitesi dhe bleresi ne vijim referuar si palet:

Meqenese:

- Shitesi ne cilesine e ortakut, ka ne pronesi nje kuote qe perben 57.2 % te kapitalit te shoqerise « **Aladini Trade Partner** » shpk me vlere totale 5.319.600,00 leke e regjistruar ne QKB me NUIS M02311002E me seli ne adresen: Rruga Sami Frasheri, ZKNr.8270, sip 311 m2 , nr pasurie 2/510+2, vol 41, fq 206/207, Bleresi shoqeria «Vigan Group »shpk shpreh interesin per blerjen e 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise « **Aladini Trade Partner** » shpk
- Shitesi ka si qellim shitjen e 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise « **Aladini Trade Partner** » shpk
- Shoqeria « **Vigan Group** » shpk dhe shitesi ortaku i shoqerise Spiro Naçi nuk kane asnje barre siguruese (sipas pergjigjes nga RBS)

Persa me siper palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash.

Duke qene té vetedijshem per rendesine e veprimeve te tyre, si dhe ne permbushje te parashikimit te ligjit «Per tregtaret dhe shoqerite tregtare» palet e mesperme vendosin te lidhin kete kontrate ne perputhje me kushte si me poshte

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATES

Palet ne kete kontrate deklarojne se objekti i kesaj kontrate do te jete shitja e nje kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit qe zoteron ortaku Z.Spiro Naci ne shoqerise « **Aladini Trade Partner** » shpk.

VIGAN GROUP
L61426009D
TIRANE, ALBANIA



A2022052940037972178

1.1 Shitesi deklaron se 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise « **Aladini Trade Partner** » shpk ne vlere totale 5.319.600,00 leke, ja shet bleresit « Vigan Group » shpk i cili eshte dakort dhe pranon te bleje kapitalin ne gjendjen qe ndodhet.

Titulli i pronesise mbi kuoten do te transferohet nga shitesi tek bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate/ me pagimin e cmimit te blerjes sic percaktohet ne kete kontrate

NENI 2

CMIMI I SHITJES

2.1 Bleresi blen nga shitesi dhe ky i fundit i shet bleresit 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise, ne vleren 2.325.000 leke (dy milione e treqind e njezete e pese mije leke)

2.2 Per blerjen e kuotes, bleresi do te paguaje shitesit shumen prej 2.325.000 leke (dy milione e treqind e njezete e pese mije leke) (ketu e tutje referuar "cmimi i blerjes")

2.3 Kjo vlere do te paguhet nga bleresi pas lidhjes se kontrates, brenda afatit kohor prej 5 ditesh, ne llogarine bankare te shitesit si vijon: Spiro Naci Banka OTP me numer llogarie 00001293499 dhe IBAN AL19 2131 1013 0000 0000 0129 3499

NENI 3

KUSHTET E KONTRATES

3.1 Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkak i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.

3.2. Kontrata quhet e vlefshme meqënëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

3.3. Në këtë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë qe shkak i ligjor i lidhjes se saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjisllacionit shqiptar.

NENI 4

DEKLARATA DHE GARANCI

TE SHITESIT

4.1 Shitesi deklaron me pergjegjesine e vet personale qe ne daten e nenshkrimin te kesaj kontrate shitje kuotash:

- eshte pronar i ligjshem i kuotes, objekti i kesaj kontrate.
- shoqeria nuk ka detyrime te prapambetura apo te pa deklaruar.
- kuotat jane te lira nga cdo barre e cfaredo lloji dhe shitesi ka te drejte, fuqi dhe autoritet te plote per te shitur, caktuar, transferruar dhe dorezuar kuotat ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.
- mbi shoqerine nuk rendon asnje ceshtje gjyqesore ku shoqeria te jete e paditur, mosmarreveshje me ndonje institucion, shoqeri apo individ, qe mund te rendojne shoqerine me detyrime ose mund ta demtojne financiarisht ate.
- nuk kerkohet asnje aprovim, leje ose dokument i ngjashem nga ndonje autoritet per transferimin e kuotave tek bleresi.
- ne rast fatkeqesie efektet juridike te kesaj kontrate do te shtihen edhe tek trashegimtarët e paleve te kesaj kontrate.



A2022052940037972178

4.2 Shitesi merr persiper dhe garanton qe pas ekzekutimit te kesaj kontrate:

- ti jape bleresit titullin e plote dhe te parevokueshem ligjor te zoterimit te 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise.
- bleresi ka te drejte per cdo dividend dhe te gjitha te drejtat e tjera qe lidhen me te.
- ti jape bleresit regjistrat kontabel dhe te gjitha dokumentacionin ligjor dhe financiar menjehere pas nenshkrimit te kontrates.
- ne rast mosmarreveshje ne lidhje me kuoten midis shitesit dhe ndonje pale te trete, shitesi do ta zgjidhe ate personalisht pa e penguar bleresin te disponoje lirisht kuoten e marrre ne baze te kesaj kontrate. Shitesi do te jete pergjegjes ndaj te gjitha pretendimeve qe dalin nga shoqeria ose palet e treta ne lidhje me transaksionet e ndermarra nga shitesi para transferimit te pronesise tek bleersi dhe do te detyrohet te demshperbleje bleresin per cdo dem ose humbje te pesuar nga ky i fundit per shkak te pretendimeve te vet paleve te treta ne lidhje me vet kuoten.

TE BLERESIT

Bleresi deklaron me pergjegjesine e vet personale qe me daten e nenshkrimit te kesaj kontrate shitje kuotash:

- i. Ka fuqine e plote per te lidhur dhe ekzekutuar kete kontrate
- ii. Kjo kontrate perben nje detyrim te vlefshem dhe detyrues per bleresin te zbatueshem ne perputhje me kushtet e saj dhe:
- iii. Pajtueshmeria me kushtet e kesaj kontrate do te rezultojne ne shkelje te ndonje dipsozite ligjore te zbatueshme
- iv. Dhe regjistrimin e saj ne QKB, behet ortak duke zoteruar 25% te kapitalit nga 100% te kapitalit themeltare te shoqerise « **Aladini Trade Partner** » shpk

NENI 5

EFEKTET E KONTRATES

5.1. Kjo kontrate ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.

5.2. Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligjit.

NENI 6

TRANSFERIMI I TE DREJTAVE

6.1. Asnjëra nga palët nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës, me përjashtim te rastit kur jepet miratimi paraprak i palës tjetër.

NENI 7

ZGJIDHJA E KONTRATES

7.1. Në rastet kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta të parashikuara nga kjo Kontratë, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

7.2. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në rast se pagesa nuk do të kryhen në afatin dhe në shumën e parashikuar më sipër.

NENI 8 **BAZA LIGJORE**

Kjo kontrate, te drejta dhe detyrimet qe rrjedhin nga palet e saj do te rregullohen, interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 9
INTERPRETIMI I KONTRATES

9.1. Në rast se do të lindë e nevojshme të interpretohet kjo Kontratë, atëherë do të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

9.2. Kushtet e Kontratës do të interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit të Kontrates.

9.3. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

NENI 10
FORCA MADHORE

10.1. Asnje pale nuk do te konsiderohet e pergjegjshme nese permbushja e ndonje dispozite te kesaj kontrate do te rezultoje ne vonese ose do te ndalohet si rezultat i forces madhore dhe vecanerisht si rezultat i revolucioneve, trazirave, levizjeve popullore, lufterave, grevave, zjarreve, permbytjeve, shpronësimit ose veprimeve qeveritare qe kufizojne lirine personale ose te ndermarrjes/ nderverpimit te seciles pale.

NENI 11
ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

11.1. Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

11.2. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të vlerësohen dhe zgjidhjen sipas procedurave juridike në fuqi të percaktuara në legjislacionin e aplikueshem të Republikës së Shqipërisë.

11.3. Palet do të përpiqen që mosmarrveshjet ndërmjet tyre t'i zgjidhin me mirëkuptim dhe ndërmjetësim dhe me pas nese nuk e zgjidhin mosmarrveshjen, palet do ti drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12
DISPOZITA TE FUNDIT

12.1 Kjo marrëveshje është përpiluar në katër kopje dhe pas njohjes dhe nënshkrimit të saj nga palët secila prej tyre merr nga një kopje, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit ndërsa një kopje depozitohet në zyrën e Noteres.

SHITESI
Spiro Naci
Ne cilesine e ortakut te shoqërise « Aladini Trade Partner » shpk

BLERESI
Shoqëria "Vigan Group" SHPK,
Arsid Rraboshta

ARSID RABOSHTA



VIGAN GROUP
16 18 179
TIRANA, ALBANIA

NOTER
ANILA Q. KAÇUPI



SHOQERIA "ALADINI TRADE PARTNER" SH.P.K
Njësia Bashkiake nr.11, Rruga e Durrësit, "Blloku Gintash", Laprake,
Ndërtese 3 katëshe, nr.1, Dyqani nr.11
Tiranë-Albania

V E N D I M A S A M B L E
"ALADINI TRADE PARTNER" SH.P.K

Ortakët e Shoqërisë "Aladini Trade Partner" Sh.p.k. sot me datën 28.01.2022 pasi moren në shqyrtim rendin e dites si me poshtë:

- Miratimi i shitjes të kuotës prej 25% të zotëruar nga ortaku Spiro Naçi, tek ortaku i ri VIGAN GROUP shpk me nipt L61426009D
- Miratimi i kontratës të shitblerjes të kuotës prej 25% të shoqërisë "Aladini Trade Partner"

K O N S T A T O I S E :

Z. Spiro Naçi, me cilësinë Administratë të shoqërisë "Aladini Trade Partner" Sh.p.k., ka kërkuar në mbledhjen e shoqërisë miratimin e shitjes të kuotës prej 25% nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë "Aladini Trade Partner" sh.p.k., tek ortaku i ri Vigan Group me nipt L61426009D si dhe miratimin e kontratës të shitblerjes së kuotave prej 25% të kapitalit të shoqërisë "Aladini Trade Partner" Sh.p.k.

Z. Spiro Naçi zotëron 57.2% të kuotës të kapitalit të shoqërisë "Aladini Trade Partner" Sh.p.k. dhe me të drejtë vote të barabarte me % e zotërimit të kapitalit Z. Spiro Naçi.

Në shqyrtimin, analizën e bëre nga ortaku i shoqërisë u shpreh për miratimin e kontratës të shitblerjes të kuotës prej 25% nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë "Aladini Trade Partner" sh.p.k., pra kalimin e 25% të kuotës të kapitalit tek ortaku i ri , Vigan Group me nipt L61426009D , me vlerë 2.325.000 Leke, me dokumentacionin bazë bashkëngjitur këtij vendimi. Për sa më lartë në mbështetje të Statutit të Shoqërisë, të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" ortaku i shoqërisë,

V E N D O S I

1. Miratimin e shitjes të kuotës prej 25% të zotëruar nga ortaku Z. Spiro Naçi, tek ortaku i ri Vigan Group L61426009D.
2. Miratimin kontratës të shitblerjes të kuotës prej 25% të kapitalit të shoqërisë "Aladini Trade Partner".
3. Kapitali i Shoqërisë "Aladini Trade Partner" Sh.p.k. në vlerë prej 9.300.000 lek, pas shitjes të kuotës prej 25%, do zotërohet nga ortakët:
 - a. Z. Spiro Naçi do të zotërojë 32.2% të kapitalit, ose 1 (një) kuotë dhe në vlefë prej 2.994.600 lekë,

- b. Z.Valer Pinderi do të zotërojë 20 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 1.860.000 lekë,
 - c. Z.Gerti Boshnjaku do të zotërojë prej 5 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 465,000 lekë,
 - d. Z.Gjergj Konomi do të zotërojë prej 1.3 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 120,900 lekë
 - e. Z.Julian Lesi do të zotërojë prej 14.5 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 1.348.500 lekë
 - f. INVG shpk do të zotërojë 2 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 186.000 lekë,
 - g. Vigan Group shpk do të zotërojë 25 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 2.325.000 lekë,
4. Gjithë dokumentacioni i përgatitur për shitjen e 25% të kuotës të kapitalit të Shoqërisë "Aladini Trade Partner" Sh.p.k., tek ortaku i ri të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit sipas kërkesave të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe statutit të shoqërisë.

Vendimi u miratua nga :


Spiro Naci

Spiro Naci



Valer Pinderi

Valer Pinderi


Gerti Boshnjaku

Gerti Boshnjaku


Gjergj Konomi

Gjergj Konomi


Julian Lesi

Julian Lesi


INVG SHPK (Pandeli Garo)

Pandeli Garo

